




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENITUJOR SHKUMBIN



VENDIM

Nr.3, datë 07.10.2021

PËR

MIRATIMIN EKËRKESËS PËR LEJE “KËRKESË PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR”, SUBJEKTIT “ELISABETA BELBA” ME VENDODHJE: BASHKIA PRRENJAS, QARKU ELBASAN

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje “Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor”, subjektit “Elisabeta Belba”, me vendndodhje: Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan sipas këtyre treguesve:

Vendndodhja e burimit ujor:

- X=549486.097
- Y=4548931.707
- Z=699m.m.n.d
- Q=0.05578 l/s

Pika e shkarkimit

- X=549468.669
- Y=4548901.707
- Z=698.5m.m.n.d

2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

SPIRO MALIQI

